

URDHËR
Nr.223, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 156, DATË 10.3.2020, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”

Në zbatim të nenit 7, pika 4 të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës, me propozim të Komitetit të Ekspertëve dhe Institutit të Shëndetit Publik,

URDHËROJ:

1. Në pikat 1, 2 dhe në të gjithë përmbajtjen e urdhrit nr. 156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, togfjalëshi “deri në datën 3.4.2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu